

Gjatë hetimit u morën aktet e ekspertimit mjeko-ligjorë toksikologjik të gjakut dhe urines së shtetasës Eleonora Bregu nr. 389 dhe 390 datë (nga 30.05.2007-20.06.2007), nga ku ekspertët kanë dale në konkluzionin se në gjak dhe në urine nuk u zbuluan prania e lëndëve helmuese (fosfororganik dhe klororganik).

Në interes të hetimit është marrë dhe administruar në dosjen e këtij procedimi edhe raporti mjekësor i dates 26.05.2007 i bërë nga 2 doktorët e Spitalit të Kujdesit Intensiv të Përgjithshëm "Amerikan Hastanesi" –Turqi, të cilët konkludojnë se në analizën e urines së shtetasës Eleonora Bregu u gjetën substanca e Benzodiazepinës dhe për këtë arsye është kuruar në diagnozën e "Intoksikimit me substance". Duke qenë se mostra e gjakut dhe urines të ekzaminuara dhe ruajtura në Institutin e Mjekësisë ligjore nuk mund të ekspertohej më për shkak të kalimit të afatit të ruajtjes, konkluzionet e marra nga analizat më të hollësishme të bëra në Turqi do të konsiderohen si prova. Në këtë optikë, meqenëse në analizën e urines së shtetasës Eleonora Bregu, u gjenden elementë të substanca helmuese "Benzodiazepinë", dilet në versionin se ajo është tentuar të helmohej me substanca intoksikuese për t'i sjellë rrezik jetës apo shëndetit të saj.

Policia gjyqësore në funksion të kesaj çështjeje ka kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore por nuk ka mundur ende të identifikojë autorët e kesaj ngjarjeje.

Në kushtet kur nuk njihen autori i kesaj ngjarjeje, në mbështetje të nenit 326/1 të K.Pr.Penale,

#### V E N D O S A

1. Pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. 1971, të vitit 2007.
2. Materjalet e kesaj çështjeje penale, do t'i kalojnë Sektorit të Policisë Kriminale për ndjekje të mëtejshme, deri në zbulimin e autorit.

Prokurori i çështjes

Sokol STOJANI



ZV. PROKURORI I RRETHIT

Albert DEMIRNELI

